

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 83896/17

KAPTAN METAL DIS TICARET VE NAKLIYAT A.S.

kundër Shqipërisë

(shih tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 7 mars 2024, si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *Kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudin, *zëvendëssekretare e Përkohshme e Seksionit,*

duke marrë në konsideratë kërkesën e mësipërme depozituar më 14 dhjetor 2017,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Detajet që kanë lidhje me kompaninë kërkuese janë paraqitur në tabelën bashkëngjitur. Kompania kërkuese u përfaqësua nga znj. A. Shehi Kalo, avokate e cila e ushtron profesionin në Tiranë.

Ankesat e kërkuetit mbështetur në nenin 6 § 1 të Konventës në lidhje me mosekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedurave në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, si edhe ankesat mbështetur në nenin 1 të protokollit nr. 1 në lidhje me pretendimin për shkelje të së drejtës së kompanisë kërkuese për të gëzuar paqësisht pronën për shkak të mosekzekutimit të vendimit dhe në mbështetje të nenit 13 të Konventës për mungesë të mjeteve efektive, iu komunikuan Qeverisë shqiptare (“Qeveria”).

Më 23 nëntor 2023, Gjykata informoi përfaqësuesin e kompanisë kërkuese me anë të postës rekomande me faturë kthimi se periudha e lejuar për parashtrimin e komenteve të kërkuetit për deklaratën për zgjidhje miqësore paraqitur nga Qeveria, kishte përfunduar më 15 shtator 2023, dhe se nuk ishte kërkuar shtyrje kohore. Vëmendja e përfaqësuesit u përqendrua te neni 37 § 1 (a) i Konventës, ku parashikohej se Gjykata mund ta përjashtojë një çështje nga lista e saj e çështjeve, në rastin kur rrethanat kanë çuar në përfundimin se kërkueti nuk kishte për qëllim të ndiqte kërkesën. Përfaqësuesi i kompanisë kërkuese mori shkresën e Regjistratit më 4 dhjetor 2023. Megjithatë, nuk pati asnjë përgjigje në vijim.

LIGJI

Mbështetur në sa më sipër, dhe në mungesë të rrethanave të veçanta në lidhje me respektimin e të drejtave të garantuara nga Konventa dhe protokollat e saj, Gjykata, në mbështetje të nenit 37 §1 (a) të Konventës, gjykon se nuk është më e justifikuar që të vijojë me shqyrtimin e kërkesës.

Rrjedhimisht, çështja duhet të përjashtohet nga lista.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 28 mars 2024.

Viktoriya Maradudina
Zëvendëssekretare e Përkohshme

Ioannis Ktistakis
Kryetar

SHTOJCË

Kërkesa në të cilën ngrihen ankesa në mbështetje të neneve 6 dhe 13 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkesit Data e regjistrimit	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e shkresës së protokolluar të Gjykatës
83896/17 14.12.2017	KAPTAN METAL DIS TICARET VE NAKLIYAT A.S. 4.2.2003	Ardjana Shehi Kalo Tirana	23.11.2023 marrë më 4.12.2023